

Njoftim për punësim

Mësues/e, për të ofruar shërbime mbështetëse për fëmijën dhe familjen në Bashkinë Durrës

Pozicioni i punës	Mësues/e
Periudha e kontraktimit	Prill 2025- Mars 2026
Zona e projektit	Bashkia Durrës
Data e mundshme e fillimit të punës	1 Prill 2025
Lloji i kontratës	Kontratë pune me kohë të plotë

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një mësues, për të ofruar shërbime mbështetëse për fëmijën dhe familjen si mbështetje passhkollore, klasa prindërimi, mbështetje individuale për fëmijë dhe të rinj në Bashkinë Durrës, në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe Eorld Vision Albania.

Mësuesi/ja do të ketë për detyrë të zbatojë në kohë dhe me cilësi aktivitetet e projektit në Bashkinë Durrës, për mbështetjen e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në këtë Bashki për të ngritur, zhvilluar dhe ofruar shërbime mbështetëse të zhvillimit individual në përputhje me nevojat akademike dhe të të nxëniet të fëmijëve.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjtet e tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti po zbatohet në Bashkinë Durrës “Forcimi i krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për të mbrojtur fëmijët dhe komunitetet vulnerabël në Bashkinë e Korçës dhe Durrësit” në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe Eorld Vision Albania. Metodologjia e propozuar bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC), standardeve ndërkombëtare të kujdesit alternativ për fëmijët dhe prioritetet kombëtare, duke përfshirë programin e Qeverisë së Shqipërisë, i cili synon të avancojë një sistem të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm për të mbështetur individët gjatë

gjithë ciklit të jetës. Ajo përdor një model socio-ekologjik që vendos fëmijën në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, i rrethuar nga katër shtresa kryesore: kujdestarët/familja, komuniteti, kultura dhe shoqëria, si dhe mjedisi më i gjerë/politikat.

Në Bashkinë Durrës, projekti synon krijimin e një strukture të qëndrueshme për shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe familjet, duke integruar ekipe të specializuara në mbështetjen e familjes, kujdesin alternativ dhe shërbimet komunitare. Fokusi është në bashkëpunimin me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, NJVNR dhe aktorët lokalë për identifikimin e hershëm të rasteve dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja. Kapacitetet e stafit të institucioneve dhe qendrave komunitare do të fuqizohen përmes trajnimeve dhe mbështetjes afatgjatë në punë. Programi përfshin mbështetje për familjet në rrezik, duke siguruar shërbime multidisiplinore si ndihma psikologjike, shërbime të specializuara, klasa prindërore, mbështetje për aksesin në shërbime, etj.

Nën mbështetjen dhe supervizimin e plotë të ekipit koordinues të programit, ***mësuesi/sja, do të ketë këto përgjegjësi:***

- Ofron, sipas grupmohave, klasa mësimore përforcuese për fëmijët të cilët frekuentojnë shërbimet ditore të SHMFF dhe orë mësimore përgatitore për fëmijët e moshës parashkollore;
- Merr kontakte me prindërit dhe ndjek pranë institucioneve arsimore të tilla si: kopshte, shkolla 9-vjeçare, frekuentimin, ecurinë dhe përparimin e fëmijëve.
- Është pjesë e ekipit të zbatimit të projektit për plotësimin e ID-Fileve të fëmijëve që frekuentojnë shërbimin për aspektin akademik;
- Kryen vizita në komunitet në bashkëpunim me ekipin e menaxhimit të rasteve për të përfshirë dhe ndjekur fëmijët përfitues të shërbimeve atje ku banojnë;
- Përfshihet në veprimtari me fëmijët jashtë SHMFF gjatë vitit, në veçanti gjatë kampeve dhe veprimtarive verore;
- Zhvillon veprimtari të gjithanshme për edukimin qytetar të fëmijëve.
- Është pjesë e ekipit lëvizëse, trajnohet dhe punon me fëmijët në këtë drejtim;
- Raporton tek eprorët çdo muaj mbi mbarëvajtjen e orëve mësimore plotësuese, mbi frekuentimin e fëmijëve dhe zhvillimin e veprimtarive sipas planifikimit;
- Harton plan mujor individual të veprimtarive/punës si dhe planin mujor të aktiviteteve me fëmijët;
- Organizon dhe realizon periodikisht veprimtari psikosociale sipas grupmohave dhe nevojave të secilit në bashkëpunim me psikologun dhe punonjësin social;
- Realizon në bashkërendim me kolegët, kryerjen e veprimtarive sipas nevojave të grupit të shënjestruar.
- Kujdeset dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e mjediseve dhe bazës materiale-didaktike dhe mësimore që përdor gjatë veprimtarive ditore.
- Raportoje te koordinatori i projektit, duke informuar për çdo rast të identifikuar gjatë punës në përditshmëri të fëmijëve në risk /të abuzuar, në vështirësi dhe në nevojë për mbrojtje.
- Respektojë Kodin e Etikës në punën me fëmijët, duke treguar kujdes gjatë përdorimit të materialeve promovuese dhe duke mbajtur parasysh parimet e mosdiskriminimit, konfidencialitetit dhe interesit më të lartë të fëmijës.
- Mbikëqyrë dhe monitorojë vazhdimisht ecurinë e rasteve, duke vlerësuar përshtatshmërinë e shërbimeve të ofruara dhe duke bërë ndërhyrjet e nevojshme për të përmbushur nevojat e përfituesve.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në mësuesi, pedagogji.
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve si dhe të zhvillimit të fëmijëve;

Eksperiencat:

- Të ketë experience pune mbi 3 vjet në mësimdhënie dhe njohuri mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore dhe punës për fuqizimin e familjeve dhe komunitetit;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet);
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe nderveprimi në punën në grup;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
- I/e gatshëm/e për të udhëtuar/lëvizur në terren;
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS dhe Politikën e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Procedura e aplikimit:

Personat e interesuar duhet të dergojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email ose me postë edhe dokumentat si më poshtë:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi

brenda dates 19 Mars 2025 në info@nisma-arsis.org , ose në adresën: Rruga "Sali Butka", Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr.7, PC 1023, Tirana Albania.

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- në subjekt të emailit ose zarfit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për pozicionin e mësuesit për shërbime mbështetëse ër fëmijën dhe familjen në Bashkinë Durrës**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.